

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

VARIANTI A

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror
(kurrikula e vjetër)

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9	10
Pikët											
Kërkesa	11	12	13a	13b	14	15a	15b	15c	15d	16	17
Pikët											
Kërkesa	18	19	20	21	22a	22b	22c	23a	23b	24	25
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Ismail Kadare***Mall*

Ca pika shiu ranë mbi qelq
 për ty unë befas ndjeva mall,
 jetojmë të dy në një qytet
 dhe rrallë shihemi, sa rrallë.

Edhe m'u duk kaq e çuditshme
 si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.
 qiejt e ngrysur pa lejlekë
 dhe shirat pa ylber në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit
 seç m'u kujtua sot për dreq:
 "Të zgjuarit janë bashkë në botë,
 kurse të fjeturit janë veç".

Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq,
 që dot s'po zgjohemi ne vallë?...
 Ca pika shiu ranë mbi qelq
 dhe unë për ty seç ndjeva mall.

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Motivi i kësaj poezie është: **1 pikë**
 - A) filozofik;
 - B) i dashurisë;
 - C) i udhëtimit;
 - D) i pasjetës.

2. Kur poeti thotë: "*Qiejt e ngrysur pa lejlekë/ dhe shirat pa ylber në mes*" i referohet: **1 pikë**
 - A) një peizazhi imagjinar.
 - B) humbjes së dashurisë.
 - C) dëshirës për një stinë tjetër.
 - D) mallit për vendlindjen.

3. Toni i kësaj poezie është: **1 pikë**
 - A) tragjik;
 - B) nostalgjik;
 - C) elegjiak;
 - D) nervoz.

4. Cili nga vargjet e mëposhtme kthehet në lajtmotiv të të gjithë poezisë? **1 pikë**
- A) Ca pika shiu ranë mbi qelq
 B) Qiejt e ngrysur pa lejlekë
 C) Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq
 D) Dhe rrallë shihemi, sa rrallë
5. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme sintaksa poetike vjen me rend të përmbysur? **1 pikë**
- A) Ca pika shiu ranë mbi qelq
 B) Për ty unë befas ndjeva mall.
 C) Të zgjuarit janë bashkë në botë
 D) Kurse të fjeturit janë veç
6. Në këtë poezi *shiu* është përdorur si: **1 pikë**
- A) shenjë errësire.
 B) simbol i trishtimit.
 C) simbol i grisë.
 D) fenomen i natyrës.
7. Ç'pjesë ligjërate është fjala *befas* në vargun: “*për ty unë befas ndjeva mall*”? **1 pikë**
- A) emër;
 B) folje;
 C) ndajfolje;
 D) mbiemër.
- 8.
- a) Cila është ngjyra mbizotëruese e kësaj poezie sipas perceptimit tuaj? Shpjegoni nëntekstin që ajo mbart. **2 pikë**
- _____
- _____
- b) Shpjegoni efektin që krijon fjala *qelq* në vargun: “*Ca pika shiu ranë mbi qelq*”. **1 pikë**
- _____
9. Cila është arsyeja që autori përdor shumësin *qiej*? Çfarë imazhi kërkon të nxisë te lexuesi përmes këtij përdorimi? **2 pikë**
- a) _____
- b) Imazhi: _____

10. Interpretoni, sipas mendimit tuaj, nëntekstin e mungesës së ylbereve në strofën e dytë.

1 pikë

11. Çfarë ideje kërkon të përcjellë poeti përmes thënies së Heraklitit?

2 pikë

12. Pse dy vargjet e mëposhtme tingëllojnë paradoksale?

1 pikë

*Jetojmë të dy në një qytet
Dhe rrallë shihemi, sa rrallë.*

13.

a) Ç'figurë stilistikore është *vjeshta* në strofën e dytë? Interpretoni domethënien e kësaj figure kaq të përdorur në lirikën e dashurisë.

2 pikë

b) Ç'ndjesi ju krijon juve si lexues imazhi i vjeshtës sipas përshkrimit të autorit?

2 pikë

14. Krahasoni dy vargjet e para të strofës së parë me dy vargjet e fundit të strofës së fundit. Cili është ndryshimi? Shpjegoni domethënien e tij.

2 pikë

PJESA II**Heminguej*****Plaku dhe deti (fragment)***

Ai po flinte, kur djali zgjati kokën te dera në mëngjes. Frynte kaq shumë erë, saqë barkat nuk kishin dalë në det dhe djalit i kishte dalë gjumi vonë dhe ahëre erdhi te kasollja e plakut siç vinte çdo mëngjes. Djali e pa që plaku merrte frymë dhe pastaj pa duart e plakut dhe zuri të qajë. Doli pa bërë zhurmë që të sillte pak kafe dhe gjithë rrugës qau.

Rreth barkës ishin mbledhur shumë peshkatarë, që vështronin atë që ishte lidhur përbri saj dhe njëri kishte hyrë në ujë me pantallona të përveshura dhe po maste gjatësinë e skeletit.

Djali nuk zbriti poshtë. Ai kishte qenë në breg më përpara dhe njëri nga peshkatarët i kishte thënë se do të kujdesej për barkën në vend të tij.

- Si është? – thirri njëri nga peshkatarët.

- Po fle, - tha djali. Atij aq i bënte që e shikonin duke qarë. - Mos e shqetësojë njeri.

- Nga hunda deri te bishti është tetëmbëdhjetë këmbë, - thirri që përtej peshkatari që e kishte matur.

- E besoj, - tha djali.

Djali e solli kutinë e konservës të mbushur me kafe të nxehtë te kasollja e plakut dhe u ul pranë tij duke pritur që të zgjohej. Një herë iu duk se plaku po zgjohej. Por plaku ra përsëri në gjumë të rëndë dhe djali shkoi përtej rrugës që të kërkonte ca dru hua për të ngrohur kafënë.

Më në fund plaku u zgjua.

- Mos u ngri, - i tha djali. - Pije këtë. Djali i hodhi ca kafe në gotë.

Plaku e mori dhe e piu.

- Ata më mposhtën, Manolin. – tha. – Ata më mposhtën vërtetë.

- Ai nuk të mposhti dot. Peshku nuk të mposhti.

- Po. Është e vërtetë. Kjo ndodhi më vonë.

- Pedrikoja po kujdeset për barkën dhe takëmet. Ç' do ta bësh kokën e peshkut?

- Le ta presë Pedrikoja ta përdorë për rrjetat.

- Po shpatën?

- Merre për kujtim po të duash.

- E dua, - tha djali. – tani ne mund të bëjmë planet tona për më vonë.

- A më kërkuan?

- Natyrisht. Me barkat e rojeve bregdetare dhe me aeroplanë.

- Oqeani është shumë i madh dhe barka e vogël, dhe është zor ta shikosh, - tha plaku. Ai vuri re se sa kënaqësi ishte kur mund të bisedoje me një njeri në vend që të fliste me veten dhe me detin.

- Më mori malli për ty, - tha plaku. – Ke kapur gjë?

- Një peshk ditën e parë. Një, ditën e dytë dhe dy, të tretën.

- Shumë mirë.

- Tani do të peshkojmë përsëri bashkë.

- Jo. Unë s'kam fat. S'kam më fat.

- Në djall të vejë fati, - tha djali. – të sjell unë fat.

- Ç' do të thotë familja jote?

- Aq më bën. Dje kapa dy peshq. Por ne do të peshkojmë bashkë tani, që unë të mësoj akoma shumë gjëra.

- Ne duhet të gjejmë një fuzhnje të mirë dhe ta mbajmë gjithnjë në barkë. Thikën mund t'ia bëjmë nga balestrat e ndonjë Fordi të vjetër. Mund ta mprehim në Guanabakoa. Duhet të jetë e mprehtë, por jo e kalitur që të mos thyhet. Thika ime u thye.

- Do të gjej një thikë tjetër dhe do ta mpreh balestrën. Sa ditë vallë do të fryjë *brisa* e fortë?

- Ndoshta dy, ndoshta tre.

- Do t'i bëj të gjitha siç duhet, - tha djali. – Ti shëroji duart e tua, o plak.

- E di si të kujdesem për to. Natën pështyva diçka të çuditshme dhe ndjeva se diçka m'u thye këtu në gjoks.

- Shëroje edhe këtë tha djali. - Shtrihu, o plak dhe unë do të të sjell këmishën tënde të pastër. Dhe diçka për të ngrënë.

- Sill edhe ca gazeta të kohës që nuk isha këtu, - tha plaku.

- Ti duhet të marrësh veten sa më shpejt, sepse kam ende shumë gjëra për të mësuar dhe t'i mund të m'i mësosh të gjitha.

Kur djali doli nga dera dhe shkoi poshtë shkëmbit të vjetër prej koralit, ai qau përsëri.

Atë mbasdite në Terracë erdhi një grup turistësh dhe duke vështruar poshtë ujët, midis gotave bosh të birrave dhe meduzave të ngordhura, një grua pa një kurriz të gjatë, të bardhë, me një bisht të madh në fund, që lëkundej e ngrihej nga batica, ndërsa era e lindjes ngrinte pa pushim dallgë të mëdha në të hyrë të gjirit.

- Ç'është kjo?- pyeti ajo një kamerier dhe tregoi skeletin e gjatë të peshkut të madh, që tani s'ishte veçse një plaçkë që priste ta merrte zbatica.

- Tiburon,- tha kamerieri! I peshkaqenit. Ai deshi t'i tregonte ç'kishte ngjarë.

- Nuk e dija që peshkaqenët kanë bishta kaq të bukur dhe të përkulur kaq hijshëm.

- Edhe unë s'e dija, - tha shoqëronjësi i saj.

Në kasollen e tij, mbi rrugë, plaku po flinte përsëri. Ai ende flinte përmbys dhe djali që ulur pranë tij dhe e ruante. Plaku shihte në ëndërr luanë.

Për pyetjet nga 16 deri në 21 rrethoni alternativën e saktë.

16. Pse peshkatarët janë mbledhur rreth barkës së Santjagos?

1 pikë

- A) Për ta parë Santjagon tek flinte.
- B) Për të parë se si barka ishte shpartalluar fare.
- C) Për të parë skeletin e çuditshëm të peshkut.
- D) Për të parë nëse Santjago kishte kapur peshq.

17. Çfarë ndodh me plakun kur kthehet në fshat pas disa ditë peshkimi?

1 pikë

- A) Turistët i kërkojnë të rrëfejë aventurën e tij me peshkun.
- B) Peshkatarët mendojnë ta ruajnë skeletin e peshkut si shenjë nderimi për të.
- C) Peshkatarët shprehin habi se si ai mundi të shkonte aq larg.
- D) Manolo i premtonte se do të peshkojë me të.

18. Djali është kaq i përkushtuar ndaj Santjagos sepse:

1 pikë

- A) ai e mëson atë si të peshkojë.
- B) ai i jep herë pas here para borxh.
- C) ai është babai i tij i vërtetë.
- D) ai mendon se mund ta shfrytëzojë Santjagon.

19. Prindërit e djalit nuk duan që ai të peshkojë me Santjagon, sepse:

1 pikë

- A) plaku është pa fat.
- B) plaku është agresiv.
- C) plaku nuk mbahet pastër.
- D) plaku nuk është vendas.

20. Djali kur pa duart e plakut filloi të qante, sepse:

1 pikë

- A) kuptoi se ai ishte në prag të vdekjes.
- B) kuptoi ç'kishte ndodhur në det.
- C) kuptoi se s'do mund të bëhej dot si ai.
- D) mendoi se ato ishin paralizuar.

21. Në këtë fragment si dhe në të gjithë veprën del natyrshëm ideja:

1 pikë

- A) e dashurisë së përjetshme.
- B) e luftës për ekzistencë.
- C) e lirisë absolute.
- D) e tjetërsimit të individit.

22.

- a) Djali shfaqet pak në këtë novelë, në fillim dhe në fund. Duke u mbështetur në këtë fragment, argumentoni se cili është roli që ai luan dhe pse është e rëndësishme prania e tij.

2 pikë

- b) Si e demonstroi djali dashurinë e tij për Santjagon, hapur apo heshturazi? Ilustrojeni mendimin tuaj me shembuj nga fragmenti.

2 pikë

- c) Pse djali i thërret Santjagos *plak*?

1 pikë

23.

- a) Në fjalinë e fundit të fragmentit plaku ëndërron për luanët. Ç' nënkuptojnë ata për plakun?

1 pikë

- b) Edhe pse Santjago kthehet i mundur, novela mbart në fund nota optimiste. Gjeni dy momente në fragment, ku ju mendoni se shfaqet ky optimizëm.

2 pikë

24. Çfarë kanë zëvendësuar përemrat në fjalitë : “ –Ata më mposhtën, Manolin, -tha , -Ata më mposhtën vërtet/ -Ai nuk të mposhti...”? Cili është funksioni i këtij përdorimi? Ç' tipar i stilit të Heminguejit zbulohet?

3 pikë

25. A mendoni se Santjago do të jetojë? Argumentoni mendimin tuaj me ilustrime nga fragmenti.

3 pikë

argumentimi: _____

ilustrimet: _____